



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 44, datë 23.09.2015

Për

**“DHËNIEN E MIRATIMIT PËR VENDOSJEN E PËRMENDORES SË HEROIT
TONË KOMBËTAR DEDË GJON LULI NË LULISHTEN E MUZEUT HISTORIK
KOMBËTAR, PRANË RRUGËS “DEDË GJON LULI””**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 10 pika 3/II shkronja “a”, neni 32 shkronja “m”, neni 33 pika 2 të ligjit nr.8652 datë. 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore “ (i ndryshuar); neni 31, paragrafi I i Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.31 datë 31.05.2004 “Rregullore e funksionimit të Këshillit të Bashkisë Tiranë” (i ndryshuar), me propozim të një grupi këshilltarësh të Këshillit Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Dhënie e miratimit për vendosjen e përmendores së Heroit tonë Kombëtar, Dedë Gjon Luli në lulishten e Muzeut Historik Kombëtar, pranë rrugës “Dedë Gjon Luli”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit si dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

ALDRIN DALIPI